

INTERVISTË ME SAIME ISUFIN

Prishtinë | Data: 2 prill, 2023

Kohëzgjatja: 70 minuta

Të pranishëm:

- Saime Isufi (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Saime, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu datën e lindjes, vendin e lindjes, diçka për prejardhjen e juaj, familjen?

Saime Isufi: Po, unë quhem Saime Isufi, kam lindur në Gjyryshec në Malësinë e Kamenicës, me 20 gusht, 1958; që tri vjeçe ne jemi shpërngulur si familje në Gjiilan dhe që atëherë familja ime ka jetuar në Gjiilan. Aty kam jetu me ni familje të madhe, xhaxhallarët. Kemi qenë tri familje bashkë në ni shpi, siç ka qenë atëherë, domethonë familje të mëdha bashkë. Aty domethonë jam rritur. Në Gjiilan kam kryer shkollën fillore. Atëherë ka qenë shkolla fillore “Vuk Karaxhiq”, tash osht’ shndërruar në “Thimi Mitko” dhe ndërtesa është tjetër, nuk është ajo e vjetra. Pas shkollës fillore pastaj kam vazhduar gjimnazin “Zenel Hajdini” katër vjet. Pas gjimnazit kam vazhduar në Prishtinë. Kam ndjekur, kam ndjekur letërsinë dhe gjuhën shqipe. Në vitin e fundit u detyrova ta lë, pa mbaruar universitetin dhe kam dalë në Zvicërr. Më vonë në vitin 1992 kam diplomuar vitin e fundit në Tiranë.

Anita Susuri: Çfarë familje është e juja? Prej çfarë familje e keni prejardhjen?

Saime Isufi: Familje ime është ni familje e thjeshtë fshatare, domethënë, mirëpo familje përparimtare. Babai im ka qenë gjithmonë një person që ka qenë aktiv në lëvizje, që nga Lufta e Dytë Botërore dhe si të thuash, pastaj unë nuk e kam pasur të vështirë kur jam lidhur, si të thush me Lëvizjen Kombëtare. Nuk e kam pasur të vështirë të veproj sepse ai ka qenë shumë, si të thuash, pro kësaj ndërmarrjes time. Pavarësisht nuk e ka ditur saktësisht se çfarë po bëj, sepse ne kemi qenë ni organizatë e msheftë, jemi detyruar të veprojmë msheftë.

Për ni vajzë në atë kohë nuk ka qenë e lehtë, si të thush të dalë nga shtëpia, të ikë natën, të shkoj në mbledhje domethonë, me si të thush, me shokët. Se unë shumicën i kam pasë shokë në lëvizjen ilegale dhe... mirëpo ka qenë nifare si lloj mirëkuptimi nga ana e babait tim, sepse ka qenë shumë i bindur që unë nuk po boj vepra të kqija, domethanë, që po eci rrugës së mbarë dhe ai ka qenë dakord me këtë. Kështu që, e kom pasur ma të lehtë të veproj.

Anita Susuri: A ka qenë baba në ndonji grup apo ka qenë...

Saime Isufi: Jo, babai im nuk ka qenë në grup, po ka ndihmuar gjatë Luftës së Dytë Botërore. E pastaj edhe ka ndihmuar, si thojnë shoktë e mi që janë strehuar pastaj ma vonë. Shoktë tanë që kanë ardhë në shtëpi, pastaj shoktë e vllaut tim, sepse vllau u organizua. E organizova vllaun. Unë isha ma e madhe dhe boja pjesë në lëvizje dhe pastaj organizova edhe vllaun tim. Vllau pastaj e zgjeroi aktivitetin. Kështu që, shpija ime ka qenë gjithmonë në çerdhe ku kanë shkuar veprimtarë, aktivistë, kanë gjetë strehë, kanë gjetë mbështetje, kanë gjetë përkrahje domethanë. Si nana, si babai im, si të gjithë familja.

Anita Susuri: E a keni qenë ju prej fëmive ma e madhja...

Saime Isufi: Po, po, unë kam qenë ma e madhja, pastaj është vllau.

Anita Susuri: Prandaj ju jeni e para që jeni kyç?

Saime Isufi: Po. Unë e para jam kyçur sepse unë kur kam qenë në gjimnaz në vitin '74. Ne si gjimnazistë, domethonë viti '74-'75 dhe kohën kur Rexhep Mala që është nga Gjilani, ai u burgos në atë kohë dhe ne dëgjonim, domethonë qëndresën e tij në burgje domethonë. Dhe ai ka qenë në nxitje edhe për ne si të ri gjimnazistë se duhet të bëjmë diçka. Domethonë e dishim, aq sa kuptonim në atë kohë domethonë si të ri entuziastë të bëjmë diçka, po nuk ishim fort, si të thush, të pjekur për të bërë veprime, për të mos rënë në sy.

Ne formuam, filluam të lexonim s'pari literaturë ilegale. Ka qenë vepra e Adem Demaçit, "Gjarpërinjtë e Gjakut", që kemi filluar ta lexojmë domethanë dhe është shpërndarë në klasën tonë. Kështu që, duke lexuar literaturë të fshehtë ne morëm vendim që të krijojmë në grup këtu, të veprojmë në grupe sepse dëgjonim që ka pasë grupe ma herët dhe duhet të organizohemi të bojmë diçka edhe ne. Kështu që, ne formuam grupin tonë, "Shqiponjat e arta" quhej domethanë dhe nxorëm edhe në fletushkë në atë kohë domethanë kështu artistike.

Mirëpo, ishim të ri, ne ishim nantë veta, tre vajza e gjashtë djem. Mbanim mbledhje, po mbanim mbledhje të hapur, nuk dinim të ruheshim. Na dukej si lojë kjo punë, si të thuash, edhe ramë shumë shpejt në sy. Pas ni viti ne, domethanë organizata ra në sy të UDB-së edhe na morën në pyetje me radhë, një nga një. Dy nga ata bile u dënuan. Ismet Ramadani, Hamdi Zymbëri u dënuan. Kurse ne të tjerët na morën në pyetje, domethanë edhe ne arsyetoeshim që si të ri nuk kemi ditur domethanë, duhej si të thush ta kamuflonin gjithë atë punë që ishte vërtetë në rrezik në atë kohë të ndërmerre ni gjë të vogël.

Kështu që edhe ata e morën... nuk na ngacmuan shumë ne të tjerëve, si të thuash, na lanë të lirë. Mirëpo, ne përsëri vazhduam, sepse në atë kohë ishte përhapur lajmi që ni grup ishte organizuar. Se ne dilshim në stadion mbajshim mbledhje, merre me mend në atë kohë që ishte diçka jo normale, ramë në sy domethanë. Edhe këto grupe tjera që ishin ma serioze, ku bonte pjesë edhe Kadri Zeka, na morën ni

pjesë prej tyne. Domethanë, biseduan me ne edhe na thanë që, “Keni dalë shumë hapur. Nëse doni të veproni, mund të organizoheni në mënyrë ma të sigurt dhe më të duhur”.

Kështu që, pastaj më ‘77-ën kam punuar në një celulë Kadrijen, jom organizuar dhe me Ismet Isufin, i ndjerë. Ishte djali i xhaxhait tim. Me këta tre kemi formuar celulën e parë kështu, si të thuash, ni veprimtari ma serioze që mbanim mbledhje të fshehur. Natën zakonisht mbledhjet maheshin. Lexonim literaturë, pastaj flisnim rreth literaturës ilegale. Si është vepruar në Shqipëri, domethonë gjatë luftës, gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, si duhet të organizohemi, si të veprojmë fshehtas.

Gjatë asaj kohe domethonë Kadriu u detyrua në ‘78-ën të dilte në... për shkak të ndjekjes domethanë ose survijimit nga ana e UDB-së u detyrua ta lshoj Kosovën dhe shkoj në Zvicërr. Kurse unë vazhdova veprimtarinë, domethanë me shokët tjerë, me shokët që kishte lanë Kadriu domethanë të organizatës. Siç janë Mehmet Hajrizi, [Hydajet Hyseni](#), [Berat Luzha](#), Jakup Krasniqi, Ismail Sylja, Jahir Hajrizi, [Teuta Hadri](#). Domethanë, janë shumë shokë e shoqe me të cilët pastaj kem vazhdu veprimtarinë deri në vitin ‘81 kur shpërthyen demonstratat, domethanë viti ‘81.

Anita Susuri: E ai takimi me Kadri Zekën si ka qenë për juve? Si ju ka dokë si person?

Saime Isufi: Nuk do ta harroj kurrë atë takim sepse ka qenë një mbrëmje kështu kur djali i xhaxhait tim më tha mua, “Shiko, ne do të takohemi sot me ni shok, do ta njohish”. Unë s’e kisha njohur Kadri Zekën, pavarësisht që kemi pasë ni miqësi nga ana e xhaxhait tim, sepse gruja e xhaxhait tim ishte teze e Kadri Zekës. Unë kisha dëgjuar domethanë po nuk na kishte ra të takoheshim. E familjen e tij e njihja. Vllzërit, motrat ishin ma të mdhej ata. Kadriu ishte ma i vogli nga, nga familja dhe ka studiuar në Prishtinë edhe ka punuar atje domethanë edhe nuk na ka ra të takoheshim.

Por, kur e takova Kadriu ka qenë, si sot më kujtohet, me një biçikletë. Doli në takim dhe djali i xhaxhait tim ishte. Ishte ni fytyrë vazhdimisht e buzëqeshur. E ka pasë ni humor shumë, shumë të hollë, si të thuash, dhe të ka bërë për të qeshur në çdo situatë; që aty ne, mu më la një përshtypje të ni njeriu shumë serioz që po punojka edhe e pashë që vërtetë mund të bënim bashkë. Mund, si të thush, mund të punonim bashkë edhe më tutje; që aty formuam celulën e parë dhe aty u betuam se do të luftojmë deri në pikën e fundit të gjakut për atdhe dhe kështu bamë.

Anita Susuri: E kur veç e keni formu celulën, cilat kanë qenë disa prej aktiviteteve që i keni bo?

Saime Isufi: Po shiko, aktivitete kështu në atë kohë, ‘78-ën nuk ka pasë aktivitete ndërmarrëse në ‘78-ën po them, derisa ka dalur Kadriu. Pasi ka dalur Kadriu në Zvicërr, domethanë filloi edhe, edhe interesimi i rinisë ma tepër. Unë kam qenë, kam banuar në konvikt, domethanë në konvikt dhe aty lëvizej domethanë. Bahej literaturë shoqe me shoqe, u krijua vetvetiu pa e ditur njana tjetren me tregu, treguan një besim domethanë. Kam studiuar letërsinë dhe zakonisht në letërsi, histori janë ato,

si të thush, në ato vende të shtynë më tepër të interesohesh, si të thush, për çështjen kombëtare dhe lexon më shumë domethanë nga historia.

Aty filluam të këmbejmë mes veti material propagandistik e kështu. Kurse unë që isha e organizuar këtej, domethanë ni organizatë vërtetë që ka bërë... është një ndër organizatat, jo që kam qenë pjesë e saj. Unë jam shumë krenare që kam qenë, po vërtetë që ka qenë më jetëgjata edhe ka qenë më domethanë, organizata që u dëshmuar edhe në fund, se Lëvizja Popullore formoi edhe UÇK-në dhe sot jemi këtu ku jemi, u çliruam. Për ne ka qenë ni ëndërr çlirimi domethënë. As që kemi besuar se do ta presim këtë ditë, domethanë. Ka qenë ni ëndërr e dëshiruar, por jo pse do ta jetonim ne.

Kështu që, ne pastaj kemi organizuar shpërndarjen e trakteve për Njëqind Vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, pastaj ardhjen e Titos në Kosovë, kemi bërë për 28 nëntorin për shembull. Filluam domethanë të shpërndanim në, nëpër popull domethanë natën. Zakonisht ato aksione boheshin natën dhe bëheshin nga dy veta bashkë edhe i caktonin terrenin se ku do t'i fusnin traktet domethanë. Ia fusnim njerëzve në shtëpi, ia hidhnim nga muri ose nën derë. Ka pasë raste kur na vërsuleshin qentë, domethanë, lehshin edhe shpejtonim ne që të iknim nga aty. Po janë, kanë qenë kohë të vështira po ta marrish kështu domethanë edhe të rrezikshme, por janë kohët ma të bukura që kam në jetën time.

Anita Susuri: E di që traktet kanë pasë përmbajtje për vetëdijësimin e popullsisë...

Saime Isufi: Po.

Anita Susuri: Për pozitën e shqiptarëve në Jugosllavi. Po a ju kujtohet ma konkretisht për shembull çka ka shkrujtë në ato?

Saime Isufi: Po gjendjen ekonomike, gjendjen politike, gjendjen sociale domethanë të... domethanë në krahasim me si të thuash me republika tjera; kemi qenë ma të shtypur, ma të diskriminuar. Femra ka pasë ni pozitë mjaft diskriminuese në Kosovë edhe ato zakonet prapanike, parambetja e të gjitha kanë bërë të vetën. Domethanë, Kosova gjithmonë ka qenë e shtypur dhe shtypi si të thush legal nuk e ka bërë punën që është dashtë ta bëjë domethanë, se ka qenë gjithmonë nën presion ajo dihet. Po ne kemi nxjerrë edhe gazeta.

Osht' gazeta "Liria" domethanë që ka qenë e grupit tonë. Pastaj osht' "Lajmëtari i Lirisë" nga Jusuf Gërvalla që e ka nxjerrë jashtë. Po ashtu "Bashkimi", Ibrahim Kelmendi edhe ai ka vepru jashtë në Gjermani. Kështu që, ne, si të thush, edhe me këtë literaturë që ka qenë shumë, domethanë rrezik të silllet në Kosovë, megjithatë është sjellur literatura nga Zvicra. Se atje ka qenë më i lehtë botimi domethanë edhe osht' sjellur në Kosovë. Edhe pastaj osht' shpërndarë aq sa ka pasë mundësi nëpër simpatizantë, nëpër popull, me njerëz. Domethanë, nifarë mënyre i ka çelë sytë, u përgatitë nifarë mënyre populli që të ndodhte ajo çfarë ndodhi në marsin e vitit 1981.

Anita Susuri: Edhe këto grupet zakonisht e kanë pasë nifarë lloj lidhje me Shqipërinë...

Saime Isufi: Po.

Anita Susuri: Por po du me folë edhe për këtë, po gjithashtu edhe për kulturën dhe ndjekjen e ansambleve që kanë ardhë ktu edhe krejt këto. Qysh ka qenë?

Saime Isufi: Po ka qenë domethanë ni... unë kam studiuar letërsi dhe në atë kohë kemi pasur edhe profesorë nga Shqipëria që na mbanin ligjerata. Ne kishim ni dashuri të jashtëzakonshme për Shqipërinë domethanë edhe për vendin amë siç osht' krejt e natyrshme domethanë. Sepse ne kishim dy rrugë, o të shkonim me Titon, o me Enver Hoxhën. Kështu që, ne kemi përsëri... kemi ndjekur rrugën e Shqipërisë dhe literaturën krejt ku jemi frymëzuar, ku jemi edukuar, ku jemi përgatitur, jemi kalitur e kemi marrë nga Shqipëria.

Ne kemi mësuar për Shotë Galicën nga veprat që kemi marrë nga Shqipëria. Për Mic Sokolin, për Bajram Currin, të gjithë literaturën e kemi marrë nga atje dhe nifarë mënyre për Hasan Prishtinën jemi përgatitur, si të thuash, dhe jemi frymëzuar nga veprimtaria e tyre për të bërë domethanë këtë që bëmë. Ansamblet kanë ardhë si, ato, si të thuash, edhe kanë qenë s'pari volejbollistet e Shqipërisë. Pastaj kanë qenë edhe ansambli shtetëror. I kemi ndjekur domethanë. Pastaj kanë qenë edhe teatrot ku osht' [shfaqja teatrale] "Cuca e Maleve", i kemi ndjekur ato. Mirëpo, gjithmonë kemi qenë të survijuar, të ndjekur, të kërcënuar nga spiunët e UDB-së që ishin në atë kohë, sepse ndjekshin njerëzit që ishin si të thuash vraponin pas tyre.

Anita Susuri: A keni ndonjë kujtim konkret diçka që, prej ktyne, domethanë, vizitave diçka që ju ka mbetë?

Saime Isufi: Po në atë, si të thuash, e di që në Teatrin e Gjilanit kam ndjekur "Baca e Gjetajve" ka qenë, si t' thuash, drama dhe Kadriu ma ka nxjerrë biletën aty. Kom shku e kom pa domethanë. Është hera e parë që kom pasë kontakt, si t' thuash, me, me ni, si t' thuash me ftyrat e ktyne. Për t'u afruar me ta ka qenë pak e vështirë, domethanë edhe ne si të organizuar kemi pasë kujdes mos me ra në sy për gjëra që nuk na ndihmojnë. Ne kemi pasë dëshirë të takohemi por duhej ruajtur se duhet të veprojmë. S'osht' qëllimi që ti të takohesh me ta të bojsh fotografi edhe të biesh në sy dhe të arrestohesh kot. Po ti duhesh të bësh ni punë ma më, si të thush, kualitative për vendin tënd. Duhesh të punosh, të mos biesh në sy fort duke vrapu pas tyre. Pastaj kur kam qenë në Zvicërr sigurisht që atje i kem pasë ansamblin shtetëror, i kam përcjellë gjatë tërë javës, si të thush, në të gjitha qytetet e Zvicrrës. I kemi pasë edhe në shtëpi, kemi biseduar me ta, jemi çmallë, kemi ndejtë kështu.

Anita Susuri: Ma vonë edhe ju me Kadri Zekën, po gjithashtu ka pasë edhe çifte tjera, a ka ndodhë që me dalë ju bashkë ose me u pa bashkë apo ka qenë rrezik kjo mos me rreziku tjetrin.

Saime Isufi: Si po mendon se ne kemi qenë të organizuar me Kadriun domethanë a?

Anita Susuri: Po.

Saime Isufi: Kemi qenë të organizuar në grup dhe normalisht ka lind dashuria aty, thjeshtë, si osht' normale, si të thuash. Po nuk kemi dalë kështu hapur, nuk kemi dalë hapur se ka qenë rrezik sepse meniherë po të merrej njëri, do të merrej tjetri se ti e din ku osht' edhe si është. Kështu që, ne jemi takuar fshehtas. Po ishte shkurt ajo, si të thuash, në '77-ën u organizuam verës në gusht dhe '78-ën në prill u deshtë të largohej në Zvicërr. Pastaj kem mbajtë kontakte, po shumë kontakte me shumë kujdes të madh, si të thuash, nëpërmjet telefonit, nëpërmjet letrave. Po ka qenë, si të thuash, ni dashuri e fshehtë të thuash. Familja ime e ka ditë domethanë edhe familja e Kadriut, po të tjerët nuk e kanë ditë sepse do të më merrnin mua menjëherë po te dinin. Unë isha edhe ma herët, si të thuash, e marrur në pyetje dhe unë kur u mora në pyetje për herë të parë unë isha futur në organizatë edhe ma të rrezikshme këtej, për ta, domethanë. Ishte domethanë edhe ngarkesa ma e madhe, si të thuash, po të ndodhke ajo.

Anita Susuri: '77-ën ju jeni marrë në pyetje niherë...

Saime Isufi: Po.

Anita Susuri: Si ka ndodhë kjo?

Saime Isufi: Po osht' marrë në pyetje ai grupi domethanë që ishin formuar sepse ai u ra [në burg]. Menjëherë nuk na morën në pyetje, si të thuash, pasi grupi u shkapërderdh. Se shifnin... unë thjeshtë u tërhoqa sepse nuk pashë ni punë serioze. Ata ishin të gjithë entuziastë, të gjithë donin të bënin diçka, po nuk dinin të bënin ni punë serioze domethanë. Edhe kështu që unë u tërhoqa, s'desha të vazhdoja më tepër aty. Pastaj unë fillove studimet në atë kohë dhe vjen vllau më thotë, "Shiko, të kanë kërkuar ty [Sigurimi Shtetëror]". Unë nuk e mora fare seriozisht, unë e dija po u bëra sikur s'dija, domethënë s'e mora shumë serioze atë ftesën e tyre. Vazhdova shkova dy ditë me vonesë unë atje, për të, nifare mënyre për t'ju treguar se nuk ishte gjoja punë edhe u mbyll. Këtej unë isha organizuar në anën tjetër.

Shkova atje [te Sigurimi], ka qenë Selim Brosha që domethënë s'osht' ma në jetë. Ai domethënë duke bërëtitur, duke sharë, duke sharë tjerët, "Pse s'ke ardhë me kohë, çka po mendon që jemi ne, kush jemi ne, si luan me ne?" Unë thashë, "Jo", thashë, "po mu më është dukur më e arsyeshme të pres të marrë..." si të thuash, ato nënshkrimet që merrnim nga profesorët kur mbaronim studimet. "Më e arsyeshme më është dukur aty, se të vija ktu se s'kam bërë asgjë", domethënë. Kështu që, më mbajtën tërë ditën me pyetje, "Jo çfarë ke dashur të bësh? Jo kështu, jo ashtu". Siç i kanë pasë pytjet e tyre. Unë u bëra sikur asgjë s'ishte ajo punë domethanë edhe me kaq u mbyll.

Anita Susuri: E thatë që ni pjesë e punës u shku jashtë...

Saime Isufi: Po.

Anita Susuri: Edhe osht' shpërnda pastaj edhe këtu. Si ka ndodhë krejt ky bashkëpunim edhe me jashtë, e në vende të Europës?

Saime Isufi: Po në vitin 1981 domethënë sepse shpërthyen demonstratat dhe morën pjesë në demonstrata domethënë të gjithë. Nga grupi jonë, si të thush, ishin më të zëshmit se ishin ma të organizuarit. Ne mbanim lidhje mes veti. Pas demonstratave nifarë mënyre pushuam kohë që të mos binim në sy, sepse ndiqeshin ata personat të cilët ishin më, më të zëshëm në demonstrata. Në atë kohë Hydajet Hyseni ishte ilegal, ishte shokë i ngushtë i Kadriut domethanë. Kadriu kaloi atje në Zvicërr, ndërkaq ai mbeti këtu domethënë.

Gjithçka është bërë në... organizata ka vendosur domethanë se si osht' ma së miri, "Ti shko jashtë, atje do të vazhdosh veprimtarinë me punëtorët. Kurse ti do të rrih këtu të bësh organizimin me njerëzit këtu", po gjithmonë duke pasur kontakte, qoftë nëpërmjet shokve që kanë shkuar atje, qoftë nëpërmjet letrave, domethanë kanë pasë lidhje. Gjithmonë janë koordinuar për aktivitetet, për ndërmarrjet që kanë bërë domethanë. Atje është nxjerrë "Liria" domethanë, organi "Liria". Pastaj "Këngët e Lirisë" janë poezitë që i kanë kushtuar si të thuash, si të thuash, poezi në një si të thuash, në një përmbajtje patriotike, revolucionare të asaj kohe.

Shpërthyen demonstratat këtu në Kosovë me 11 mars [1981], siç është i njohur pastaj 26 mars e ni, e 2 prill, e siç domethanë morën përmasa të mëdha. Në pyetje ishte atje jashtë se çfarë do të bëhej. Në atë kohë Kadriu ishte, kishin OMLK-ja kishte nxjerrë Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës. Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Ishin disa teza në të cilat ishin të përfshirë burra, gra, djem të ri, të reja, të gjithë pa dallim feje, gjinie, krahine të, të bëheshin të bashkoheshin me ni front për Republikën e Kosovës. Atëherë ishin në pyetje të formohet republika sepse edhe nga demonstratat doli kërkesa republikë e para nën Jugosllavi, kjo ishte kërkesa e parë.

Kështu që, Kadriu bëri përpjekje atje sepse vepronin Jusuf Gërvalla që i takonin ni organizate tjetër, Ibrahim Kelmendi gjithashtu i takonte ni organizate tjetër. Ata mes veti, si të thuash, kishin kontakte, kishin ndëgjuar sepse i kishin edhe rrënjët edhe këtej domethanë, degët në Kosovë. Kështu që, u morën vesh, filluan të bisedonin rreth bashkimit, domethanë bashkimi bën fuqinë, siç e dijmë. Kjo ishte përpjekja e Kadriut në atë kohë për bashkimin e organizatave. Po ashtu pas 11 marsit kur u, domethanë, kur u bën demonstratat dhe 1 e 2 prilli ndodhi këtu normal që edhe jashtë ndërmerrej diçka. Kadriu i mblodhi kta Jusufin e Ibrahimin Kelmendi domethanë veprimtarë që ishin dhe shoktë e tij.

Normal që i kish organizuar në celula në Zvicërr. Menjherë kishte fillu punën me shokët të cilët ndoshta kishin qenë të organizuar në Kosovë dhe vepronin, punon në Zvicërr dhe pastaj ky i ofroi ata

njerëz domethanë ma të devotshëm që ishin dhe ata pastaj zgjeruan edhe rrethin. Unë kur shkova në vitin '81 domethanë ishte koncerti me rastin e 29 nëntorit, çlirimit të Jugosllavisë dhe po bëhej në koncert me këngë shqipe dhe serbe, siç kanë qenë atëherë.

Unë nuk e harroj kurrë atë moment kur punëtorët mërgimtarë u ngritën në këmbë dhe filluan, “Kosova Republikë”, të bërtasin aty. Domethanë të thërrasin “Kosova Republikë”. Ishte në gja e jashtëzakonshme, në entuziazëm i punëtorëve. Atëherë thashë, jo Kosova, domethanë Republika qenka afër si të thuash. Kështu që, ishin këta punëtorë të cilët kishin, si të thuash, kishin marrë pjesë në demonstratat të organizuara në perëndim. Pasi mbaruan demonstratat këtu në Kosovë, duhej dikush t'i mbështese ato. Sepse shtypi ishte shumë i, domethanë, nuk kishte mundësi ti të flisje hapur për demonstrata dhe si të informoje opinionin botëror.

Kadriu bashkë me vllazërit Gërvalla, me Ibrahim Kelmendin që ishin aktivistë domethanë, ishin veprimtarë, atje organizuan demonstratën e parë me 11 prill [1981] në Bern, në Zvicërr. Kjo ishte demonstrata e parë, hapi i parë. Domethanë, u thye akulli siç thuhet në popull në Bern dhe pastaj vazhduan edhe tetë demonstrata. Në Belgjikë, në Dusseldorf, në Bonn, në Vjenë është bërë demonstrata tjetër. Pastaj në Bruksel. Kështu që, nëntë demonstrata vetëm në pranverë dhe verë të vitit '81 janë mbajtur në, në perëndim.

Aty, si të thuash, kanë foluar Kadriu, vllazërit Gërvalla, Ibrahim Kelmendi të gjithë ju kanë mbajtur fjalim punëtorëve dhe ju kanë dërguar peticione. Ato, si të thuhet, zakonisht demonstratat janë ba para institucioneve ndërkombëtare ose para ambasadave ose konsullatave Jugosllave aty. Vazhdimisht janë dërguar peticione me kërkesa të qarta aty. Domethanë, “Kërkojmë Republikën e Kosovës” “Duam punë në vendlindje ne si punëtorë” “Jemi në mbështetje të punëtorëve, të studentëve, të fshatarëve” “Jemi në mbështetje të Republikës së Kosovës” “Republikë, Kushtetutë! Ja me hatër, ja me luftë!” Kjo ka qenë parolla në demonstrata e protesta. Kështu që, domethanë kjo ishte veprimtaria në pranverë, verë të vitit '81 në perëndim.

Po ashtu mbaheshin edhe mbërme informative me punëtorët rreth, si të thuash, rreth ni demonstrate, rreth situatës në Kosovë. Mbaheshin takime, për shembull 28 nëntori të vitit '81, s'e harroj, është mbajtur në Stuttgart. Ishin bashkuar të gjithë aktivistët e verës e të pranverës edhe pjesëmarrësit e demonstratave. Festuan bashkë 28 nëntorin edhe kështu që klubet gjithashtu. Klubet që ishin nën patronatin e shtetit jugosllav filluan të shndërroheshi në klube shqiptare, të bëheshin të pavarura. Ishin për shembull edhe ato që ishin akoma, siç ishte, klubi “Përparimi” në Cyrih, që ishin akoma nën, si të thuhet, nën, si të thuash, nën ambasadën jugosllave.

Aty, aty ishin ata persona të cilët bënin aktivitetin edhe pse ishin aty domethanë, si klub organizoheshin aktivitete, takime, mbledhje, pa ditur domethanë këto, si të thuash, pa u njohur ambasada jugosllave. Pastaj filluan edhe në Gjermani, në Gjenevë të Zvicrës të formohen klube të pavarura, “Emin Duraku”, “Emine Prishtina”, klube të tjera domethanë, njëra pas tjetrës ku mbaheshin

aktivitete. Vërtetë viti '81 ishte ni kthesë e madhe edhe për bashkëatdhetarët tanë. Pavarësisht që bashkëatdhetarët nga këtu, kjo pjesëmarrje edhe me kthimin në Kosovë ni pjesë e madhe u detyrua të qëndroj atje për shkak të rrezikimit sepse ishin kërkuar ose ju merrej pasaporta posa të ktheheshin në Kosovë. Kemi raste që janë burgosur bashkëatdhetarët tanë, por kjo osht' jeta, kjo osht' lufta. Pa sakrificë, pa gjak nuk vjen liria. Veç edhe kjo ishte ni pjesë e asaj borxhi që ia kishim Kosovës.

Anita Susuri: Zonja Saime, desha me folë për demonstratën e '81-tes edhe për përvojën e juaj prej se ka fillu...

Saime Isufi: Po. Domethanë, sa i përket demonstratave të '81-shit më kujtohet që me 11 mars nuk kam qenë këtu në Prishtinë. Kam pasur nënën e smutë, dhe si të thuash, në atë kohë nuk kam ndenjur këtu. Mirëpo, në atë natë, në atë demonstratë ka marrë pjesë edhe Nuhi Berisha, sot dëshmor i kombit. Me Nuhi Berishën kemi qenë me ni celulë, bashkë me Nuhi Berishën dhe vllaun tim. Këta ishin më të rinjë se unë dhe unë kam, si të thuash, jemi afruar dhe kemi punuar me një celulë.

Të nesërmen vjen drejt në Gjilan dhe më thotë, "Shiko, kështu, kështu, ka ndodhë mramë një demonstratë". U habita domethanë se ishte pak e papritur. Si të thuash, nifarë mënyre ishte ni, ni vlim gjithkund nëpër konvikte të studentëve, këmbenim literaturë mes veti pa u njohur shumë mirë por kishim fituar ni lloj besimi domethanë, ose dëgjonim Radio Tiranën domethanë. Ajo ka qenë ni dritare shumë, shumë e mirë për ne që dëgjonim Radio Tiranën, si të thuash edhe kemi pasë edhe shoqe nga Maqedonia ose nga Struga, nga... kështu që, kemi qenë shumë në kontakt të mirë me to dhe këmbenim literaturë mes veti.

Unë u habita domethanë kur më tregoi Nuhiu, domethanë se ka pasë, si të thush, ka qenë demonstrata. Më tregoi në hollësi. Pastaj, kam ardhë në Prishtinë normal dhe pastaj filloi demonstrata e 26 marsit domethanë, pritej stafeta e Titos. Edhe aty dihej që do të, do të ketë pjesëmarrje. Mes veti, do të dali unë, do të dalë ai, do të dalë ky, domethanë. Kështu kemi dalur, kemi dalë secili, po nifarë mënyre secili kokë më vete. Domethanë, të gjithë, ishin disa organizata ilegale po nuk ishte nifarë organizimi domethanë ose ni koordinimi të përbashkët. Po kush sa, domethanë, sa mund të fliste ose çka mund të thonte aty.

Kemi dalur domethanë me shoqet, si të thuash nga konvikti, iu kemi bashkangjitur turmës. Veç domethanë kur e kom pa Hydajet Hysenin maje blinit atje (qeshë) duke majtë fjalim si të thuash. Ai ka qenë entuziazmi i madh dhe ka qenë i maskuar. Shumica e kanë ditë në atë kohë që osht' ni punëtor i "Ramiz Sadikut", ndërsa ne e dishim që ishim dhe si të thuash jemi afruar aty që ta ruajmë, mos t'i ndodhi gjë. Nuk i ndodhi, iku domethanë, i shpëtoi arrestimit. Kjo ka qenë ni përvojë shumë, shumë interesante domethanë, dhe shumë e paharruar. Pjesëmarrja në demonstrata, me parolla, me thirrje.

Pastaj kemi pa edhe shokë e shoqe duke na u arrestuar para syve, duke na, duke u goditur, duke u goditur me shkopinjë e derisa ranë edhe në atë kohë Naser Hajrizi, Asllan Pireva. Bile, sot është

përvjetori i dyre i 42-të ku do të marrë pjesë sigurisht meqenëse qëllova këtu. Kjo e nxiti edhe më tepër pastaj, vala e arrestimeve edhe burgosjeve e nxiti edhe më tepër që të shpërthenin demonstratat me 1 edhe 2 prill. Aty u bashkuan të gjithë, si të thush, i madh e i vogël. Ishte një pjesëmarrje e jashtëzakonshme.

Mirëpo, ne si të organizuar, si të thuash, ne kishim kujdes të mos ekspozohemi shumë domethanë, sepse duhej veprimtaria, ajo demonstrata do shkonte dhe duhej veprimtaria të vazhdonte edhe më tutje. Kështu që, pastaj unë kam vazhduar aktivitetin jashtë vendit, sepse në tetor të '81-shit unë shkova në Zvicërr atje. Filluan arrestimet edhe të shokëve të organizatës prandaj u detyrova të qëndroj atje.

Anita Susuri: A keni qenë edhe ju e përndjekur, në rrezik e keni ndje vetën?

Saime Isufi: Po sigurisht se unë i takoja organizatës. Sot janë edhe ato aktakuzat edhe si të thuash ku jam në, kam qenë anëtare e Komitetit Ekzekutiv. Ka qenë Komiteti Drejtues, domethanë organi ma i larti i organizatës tonë, pastaj ka qenë Komiteti Ekzekutiv. Unë kam qenë aty anëtare e këtij Komiteti. Kështu që, rreziku ka qenë i natyrshëm.

Anita Susuri: Gjatë protestave e demonstratave, 1 e 2 prilli që kanë qenë ma të mushme...

Saime Isufi: Po, po, po.

Anita Susuri: Në masa ma të mdhaja. Qysh, qysh ka qenë qyteti, policia qysh osht' sjellë? Njerëzit?

Saime Isufi: Shikoni, policia domethanë, janë polici speciale ma si do të ishte ajo, me flakë shkonte Kosova, s'dihej çka po bëhej, çfarë ndjekje domethanë. Dhunë me gazlotsjellës me autoblanda, me domethanë gjithçka ka qenë ni... po njeriu gjen, s'di, gjen si të thush, forcën për të përballu domethanë. Duke pasë shok e shoqe afër mundohesh domethanë të japësh kurajo, të, të bashkëveprosh me ta, të mos dorëzohesh si të thuash. Dyert i kemi hapur nëpër shpi, nëpër shpi ku kemi kërkuar, si të thush strehim në atë ditë. Dikush sillte ujë, dikush sillte për shkak të gazit lotsjellës, dikush qepë, dikush domethanë ishte vërtetë ni solidaritet i jashtëzakonshëm në atë kohë, sepse ne shqiptarët dihet në raste të vështira jemi shumë shumë solidarë mes veti e kështu.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Pastaj thatë që jeni largu, në tetor a po?

Saime Isufi: Po, po.

Anita Susuri: Po në ndërkohë çka keni bo? A ka vazhdu ende aktiviteti këto kohë apo ka qenë shumë rrezik?

Saime Isufi: Po ne jemi takuar domethanë, ne jemi takuar në atë kohë po shumë fshehtë, shumë rrallë. Shumë me ni kujdes ma të madh domethanë që të mos binim në sy. Jemi takuar domethanë, jemi, për shembull, i kemi pasë ato parullat tona. Në kaq ora, në filan vend domethanë edhe jemi takuar, jemi takuar zakonisht natën. Kështu ka qenë në atë kohë.

Anita Susuri: Më doket ka qenë ni aktivitet i shkrimit të parollave, “Kosova Republikë”.

Saime Isufi: Po, po. Ka qenë domethanë ajo ni kohë. Unë si të thuash kurrë s’e harroj, kurrë! Ka qenë koha e shkrimit “Kosova Republikë” e parollave. Unë bashkë me Nuhi Berishën në Gjilan kemi shkruar parolla rreth e rreth Gjilanit me ngjyrë të kuqe. “Kosova Republikë”, në rrugë, domethanë në rrugë të asfaltuara në atë kohë që kanë qenë ose në institucione, në shkolla për shembull. Shkolla, në atë kohë Shkolla Ekonomike në Gjilan, kemi shkru parollën. Kemi shkru rrugëve rreth e rreth qytetit të Gjilanit domethanë. Aq sa kemi mbri, natën vonë. Të shkruanim parulla edhe kur osht’, domethanë kur osht’ bo mëngjes njerëzit janë habitur, “O çfarë parolla”. Domethanë, i dëgjonim pastaj se çfarë, sikur kush e di çfarë ishte bërë. Ne e dishim që ishim domethanë autorë të atyre parullave aty...

Anita Susuri: A keni dëgju, a ka pasë arrestime për kët parulla si zakonisht, ata që kanë qenë të dyshun i kanë arrestu ose...

Saime Isufi: Me të thanë të drejtën nuk e di për atë kohë a ka pasë arrestime, nuk kam domethanë rreth atyne parullave. Jo, nuk di, s’mund të them. Ka mundësi, po nuk e di. Po ne s’jemi zbulu, kryesore. Autorët.

Anita Susuri: Cila ka qenë koha kur veç keni qenë shumë në rrezik që jeni detyru m’u largu? Ka qenë ky tetori apo edhe ma herët?

Saime Isufi: Po shiko, na të rrezikum kemi qenë vazhdimisht, si të thuash domethanë. Përderisa bon pjesë me ni organizatë ilegale, ti gjithmonë je, si të thush, në ndjekje edhe sidomos që e ke ni... ma herët nëse ke vepruar diçka do të dihej. Në qoftë se, do të kuptohej lidhja... se filloi të pëshpëritej, “Kjo ka lidhje me Kadriun”, se edhe na kishin pa ndonjëherë. Se edhe kur ishim takuar për të këmbyer ni libër a diçka, a ni literaturë e kështu, kishte rënë në sy domethanë. Nifarë mënyre pëshpëritej që ne kishim ni lidhje mes veti, nuk dihej se çka domethanë. Pastaj, dyshimet ishin për atë ose për këtë. Po, kemi qenë, si të thush, të rrezikuar kemi qenë. Unë kam shkuar te Kadriu, kam shkuar për t’u kthyer në fakt. Kam shkuar vetëm për ta vizituar dhe për t’u kthyer. Por, pastaj fillunë arrestimet atje në Kosovë dhe prandaj u detyrova të qëndroj. Përndryshe, po të kthehesha unë do të burgosesha si shoktë e shoqet e mija.

Anita Susuri: E si ka vazhdu jashtë domethanë, ju jeni martu thujse...

Saime Isufi: Po, po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë krejt qajo periudha?

Saime Isufi: Po unë do të thosha para se të kaloja atje, do të thosha për '81-shin kur ne ishim në konvikte edhe më kujtohet si sot me 26 qershor kur u mbyllën shkollat, u mbyllën universitetet se dihej që aty nuk kishte ma qetësi. Pas gjithë atyre që ndodhën, na burgosën shoktë, na burgosën shoqet, u bo gjithë ajo dhunë e terror kundër demonstruesve. Na nxorën nga konviktet dhe me dhunë na shpërndanë në qytete tona. Domethanë, më kujtohet si sot me autobus. Me autobus, u organizunë autobusët dhe na futën në autobus dhe do të ktheheshim në vende tona. Domethanë, u mbyll gjithçka.

Universitetet s'e harroj që mbeti shkret aty, domethanë gjithë ai vlim i studentëve, gjithë ajo kohë, gjithë ato andrra, gjithë ato kujtime u shuan për ni moment domethanë dhe ne u detyruam të kthehemi, të ktheheshim në shtëpi. Pastaj, unë unë shkova në Zvicërr atje. Atje normal që gjeta Kadriun edhe dilte "Liria", gazeta "Liria". Dhe kemi punuar bashkë si të thush. Unë në, sa kam qenë në Kosovë kam mësuar shtypin, daktilografinë, si të thuash, me makinë shkrimi. Ma ka dhënë, sot ndodhet në Hagë, më vjen shumë keq për Jakup Krasniqin, ka qenë edhe ai në Komitetin Ekzekutiv. Ne kem punuar bashkë.

Në atë kohë duhej të mësonin, domethanë t'i shtypshim vet traktet të mësoheshim. Ai ma ka dhënë makinën shtypëse dhe librin për të mësuar unë, si të thuash, për të shtypur. Dhe sot e atë ditë më ka shërbyer shumë, e kam përdorur shumë. Kështu që, kur kam shkuar në Zvicërr kam qenë e gatshme si të thuash. Atëherë kanë qenë do makina primitive, nuk janë sikur këto sot. Ne duhej të merrnim germën A, për shembull, kishim bërë gabim ta merrnim, ta ngjitnim, ta prinim me gërrshënë. Domethanë, e ke parasysh ni germë kaq të vogël? Dhe ta vënim në, si të thush, në ni artikull ose në ni shkrim. Kemi vazhduar atje domethanë. Ka qenë numri i fundit i "Lirisë", sepse unë shkova në tetor dhe ajo ndodhi më 17 janar domethanë.

Tre muaj përparësisht që qëndrova në Zvicërr domethanë që, si të thush, me Kadriun. Gjatë asaj kohe ne kemi përpiqeshim... shokët ranë në burg ktu, u burgosën të gjithë. Ne mbetëm atje, filluan provokimet në telefon të Kadriut, atje në Zvicërr. "Jo jom filani, jo..." paraqiteshin në emër të pseudonimeve që kishim, sepse ne kemi pasë pseudonime. Unë për shembull kom pasë pseudonimin Bule. Ni pjesë e bashkëatdhetarëve, ni pjesë e njerëzve atje më thrrasin Bule, si të thuash edhe kështu që e thrrasin domethanë e provokonin në telefon.

Kadriu shkoi me merakun se çka ka ndodhë me shokët se nuk e mori vesh saktësisht. E diti që diçka u bo po nuk... se filluan domethanë lidhjet u shkëputen në atë kohë. Kështu që, ne filluam numrin e

fundit të “Lirisë” ta nxirrnim bashkë. E dërguam në Gjermani. Në Gjermani është botuar dhe pas vrasjes së Kadriut na është dorëzuar gazeta. Atje domethanë këto janë tre muaj si të thuash, veprimtari. Kemi shkuar te vëllezërit Gërvalla, te ta. Kemi qenë në Dusseldorf kur është hapur grupi i pavarur, klubi i parë, si të thuash, grupi i pavarur në Gjermani. Kemi marrë pjesë aty. Kemi marrë pjesë 28 nëntorin bashkë me Vëllezërit Gërvalla, me bashkëatdhetarët. Domethanë, këto kanë qenë si të thuash aktiviteti i ynë.

Po ashtu me 2 janar [1982], që ndoshta vlen të përmendët, Kadriu ishte, donte që këta bashkëatdhetarë që kanë marrë pjesë domethanë në, në aktivitete, në demonstrata, donte pak, si të thuash, t’i, pak t’i freskonte në diçka më ndryshe. Bashkë me shokët organizuan. Dasmën e kemi bërë me 2 janar në Zvicërr. Domethanë në ni shtëpi kështu pushimi në Zvicërr dhe u ftuan të gjithë. I kishim krushqit, si të thuash, të demonstratave. Ne s’kishim familjarë asnjë, asnjëri aty prezent. Po kishim, si të thuash, njerëzit ata dhe luftëtarët e vitit ‘81 që kishin marrë pjesë në demonstrata dhe janë inxhizimet. Për fat osht’, si të thuash, ai inxhizim i asaj kohe. Ni kujtim shumë i bukur, shumë i mirë i ni ngjarje. Si të thush, ajo u shndërru ma tepër si ni lloj veprimtarie, sepse të gjithë ishin shumë... kënduam këngë patriotike. Ishte dasëm e veçantë, nuk ishte dasmë kështu e zakonshme...

Anita Susuri: Për me ngritë ndoshta edhe moralin...

Saime Isufi: Edhe moralin e njerëzve edhe pak ni lloj freskie, si të thush edhe për bashkëatdhetarët. Ni lloj shpërblimi për bashkëatdhetarët, për të gjithë atë punë që kishin bërë kështu.

Anita Susuri: A ka qenë dasmë e madhe?

Saime Isufi: Jo.

Anita Susuri: A ka pasë shumë njerëz?

Saime Isufi: Rreth njëqind veta mund të kenë qenë, po. Ata ndoshta njëqind jo, më pak. Po ishte ni pjesë, pjesa e atyne të demonstratave. S’kishin ardhë të gjithë sepse edhe aty ishin zgjedhë pak edhe njerëzit që kishin qenë ma aktivistë, si të thuash, ma aktivë që kanë... që kanë qenë ma të, si të thush, ma të rënë në sy edhe për gjatë pjesëmarrjes në demonstrata kështu edhe ma aktivë. Këta kanë marrë pjesë.

Anita Susuri: Pastaj ju keni jetu bashkë me Kadri Zekën, me bashkëshortin e juj. Si e keni marrë atë lajmin? Si ka ndodhë krejt kjo?

Saime Isufi: Po. Atë natë ka qenë domethanë, ka qenë dikund rreth orës dhjetë kur Ibrahim Kelmendi më ka telefonuar mua. Më thotë, “A osht’ kthyer Kadriu?” Thashë, “Jo, nuk osht’ kthyer”. Normalisht që Kadriu do të kthehej atë natë sepse ishte e diel dhe të hënën do të punonte. Nuk u kthye. Ai ka dalur të

flas, të më njoftoj në telefon që sonte nuk po kthehet, se normal unë u boshja marak. U bojshe marak thjeshtë që edhe po të mos ishte aktivist që ni gru apo ni burrë bohet marak kur s'kthehet pa paralajmëruar. Ata nuk kishin telefon në shtëpi, vllazërit Gërvalla, kështu që kanë dalur të telefonojnë në ni kabinë në atë kohë. Duke dalur ka ndodhë ajo se kanë qenë në pritë. E kanë pritur.

Ata veç kanë dashur që këta tre të bëhen bashkë dhe t'i vrasin. Kjo ka qenë domethanë puna e UDB-së. Rreth orës dhjetë më merr Ibrahim Kelmendi edhe thotë, "A ka ardhë? Po do të vijë", thotë, "se isha bashkë me të". "Në rregull", s'bëra zë. Pastaj kërkoi ni shok. Prapë thirri Ibrahim Kelmendi të kërkoj ni shok të Kadriut osht' Hasan Malaj, që e kanë pasë njeriun më besnik e më të afërt të tij. Thotë, "Dua Hasan Malën, a është Hasan Mala aty?" Thashë, "Jo", thashë, "më thuaj mua". Se dyshova, meniherë e dita që diçka paska ndodhur. Thashë, "Më thuaj mua. Nuk po ta jep Hasan Malën". "Jo", tha, "nuk ka ndodhë asgjë, ai do të kthehet", dhe e mbylli telefonin.

Pastaj ka ardhë Hasan Mala dhe i thashë, "Kështu kështu, Ibrahim Kelmendi", këtë e tha, "diçka mund të ketë ndodhë". Tha, "Jo", tha "mos e ço mendjen për të keq menjëherë. Mos të shkoj menja". Po edhe ai ndihej keq domethanë sigurisht. Pastaj, telefoni prapë Ibrahim Kelmendi e mori Hasan Mala mori telefonin. Tha, "Dua të ju lajmëroj", tha, "se ka ndodhur ni atentat në Gjermani. Kadri Zeka", tha, "Kadriu i vdekun", këtë e dëgjova se ishte, heshtja ishte natë. Këtë e dëgjova. Për ata dy nuk po dihej, sepse Jusufi ishte i plagosur.

Ky tashti u ndje keq se mendoi që s'e dëgjova. Unë e dëgjova veç u mpira, domethanë s'bëra asgjë, s'reagova veç, vetëm nejta kështu siç isha. Tha, "Shiko", tha, "Bule do të nisemi për Gjermani se Kadriu qenka sëmure", thashë, "Jo, unë e dëgjova shumë mirë, po s'kam çfarë të bëjë. E dëgjova shumë mirë lajmin, s'kam çfarë të bëjë". Thirri pastaj ni shok, erdhi ni shok na mori dhe u nisëm domethanë me makinë. Në fakt shkruam deri në Cyrih... në St. Gallen kemi jetuar ne me Kadriun. Prej aty u nisëm me tren të shkojmë te ai shoku i cili kishte makinë. Me makinën e tij do të shkonim.

Gjatë rrugës, mu më kujtohet si sot, unë nuk qava fare as aty në shpi, as rrugës. Këta qanin, shokët, domethanë, qanin. Thashë, "A do të më çmendni mua, a çka keni?" Mua vetëm gjujtë, e di si sot, si mbaja dot gjujtë. Më dridheshin gjujtë dhe s'i përmbaja dot gjujtë e mi duke ecur. Nuk kam qaj të tanë rrugën, si e mpirë domethanë (qan). Kur kemi arritë te familja Gërvalla... gjatë rrugës, më fal dua ta them, që Hasan Mala që kam pasë në vend të babës pas rënies së Kadriut, m'u ka ndodhë shumë pranë. Ia kam borxh të jetës.

Mbante gjoksin, thonte, "Do të më dali gjoksi nga vendi". "O Kadri", thoshte, "kë le mrapa? Po dikë ke lënë mrapa. Çka do të bëjmë ne pa ty?" Kështu domethënë (qan). Arritëm në shtëpi të vllazërve Gërvalla. Për Kadriun e dishim, për tjetër nuk e dishim se s'morëm vesh asgjë, se s'ka pasë atëherë këto mundësitë e komunikimit, ma s'ke pasë. Ke dalë nga shtëpia, ma s'ka telefon as asgjë. S'merrej vesh asgjë. Mezi e gjetëm edhe rrugën atëherë, ishim shumë të çorientuar e të mërzitur e të gjitha ato. Mezi që e gjetëm vendin.

Kur arritëm aty del shoqja e Jusufit [[Suzana Gërvalla](#)] thotë, “Hajde nuse”, unë isha nuse, as dy javësh. Thotë, “Hajde nuse, tre të vdekur”. Ishte një bombë. Pavarësisht që dhimbja ishte e madhe për Kadriun, por të paktën dikush të shpëtonte, ishte shumë e rëndë. E kjo ishte domethanë. Pastaj, aty njerëzit, bashkëatdhetarët të gjithë u ngritën në kambë sepse këta ishin, si të thuash, krerët, udhëheqësit e tyre. Ishte një, një shok për të gjithë. Më vinin të gjithë aty për ngushëllime, për ndihma materiale. U përpoqën t’i kthenin domethanë në Kosovë, jo në asni mënyrë, ambasada nuk lejonte. Domethanë, osht’ bo varrimi pas tri javësh, si të thuash, në Gjermani se nuk lejuan të ktheheshin dhe kështu.

Anita Susuri: Pastaj si e përmendet edhe në Kosovë kanë qenë shumica të arrestum...

Saime Isufi: Po, po.

Anita Susuri: Edhe keni mbetë faktikisht ni grup shumë i vogël jashtë. Si jeni rimëkëmbë?

Saime Isufi: Shiko, ne jemi përpjekur edhe atje jashtë, sepse Kadriu dhe Jusufi atë natë janë bashkuar. Atë natë domethanë që janë vra ata edhe janë bashkuar atë natë, sepse bisedimet kanë qenë për bashkim. Pastaj ne sigurisht që siç është ajo fjala “Një bie e mijëra ngriten” edhe te ne ka qenë kjo moto. Pastaj, si të thuash, bashkëatdhetarët, ne filluam protesta për vrasjen e tyre. Ka qenë protesta e parë që u organizua në Stuttgart. Pastaj vazhduan protestat domethanë. Ne, ata që ishim të organizuar, sepse shoktë, ata e kishin e kishin bërë punën e tyre. Ne s’ishim në nivelin e tyre të bënim punën e tyre.

Megjithatë, në ato forcat tona ne gjetëm forcë e kurajo për të vazhduar punën dhe filluam të vazhdojmë te shoktë e Jusufit, shoktë e Kadriut këtej. Domethanë, të vazhdojmë punën. Ibrahim Kelmendi mbeti dhe të vazhdojmë protesta, demonstrata, të nxjerrim gazetën. U bo ni lloj bashkimi atje, si të thuash, dhe filloi dalja e “Zërit të Kosovës”. Domethanë, puna nuk është ndalur asnjëherë. Pastaj filluan, që u arrestua ni pjesë këtu në Kosovë, ni pjesë doli jashtë. Kishte edhe grupe tjera, se u mor vesh pastaj kush ishte në grupe, nuk kishte ma fshehtësi si të thuash.

Dolën edhe jashtë për shembull ku ndodhi vrasja edhe e Rexhep Malaj dhe Nuhi Berishës këtu në Kosovë. Pastaj kishin, kishte njerëz që kishin qenë anëtarë domethanë të grupeve dhe dilnin jashtë. Ishin kuadro ma të përgatitur ose kishin dalë nga burgu. Kështu që, filluam edhe ne si të thush të rimbëkëmbënim. Më vonë doli Xhafer Shatri që ishte shok i yni, doli nga burgu. Kështu që, aktiviteti ka vazhduar pa ndërprerë deri në fund.

Anita Susuri: Ju prej jashtë keni vazhdu me, sigurisht, edhe me publikimin e gazetave...

Saime Isufi: Po, po. Unë kam qenë ni kohë redaktore e “Zërit të Kosovës”, kam qenë edhe anëtare e “Zërit të Kosovës”, si të thuash, anëtare e redaksisë. Kemi pasë redaksinë e botimeve “Liria”, ku osht’

nxjerrë “Zëri i Kosovës”, janë nxjerrë materiale të ndryshme. Domethanë, libra për Nuhi Berishën, për Adem Demaçin, për Jusuf Gërvallën, për Kadriun, si të thuash. Domethanë, vazhdimisht kemi qenë, si të thuash, në, në veprimtari, në veprim. Nuk jemi ndalë asniherë. Trakte të ndryshme, informacione të ndryshme. Kemi pasë për fat të mirë, këtë duhet ta theksoj, një çift zvicerran Beart Shafer edhe Catrina Salt të cilët në qytetin ku jetoj edhe sot që 42 vjet, jetoj edhe sot. Aty kemi pasë në adresën e gazetës “Liria”, ku ka vazhduar më vonë edhe “Zëri i Kosovës”. Ai çift zvicerran na ka ndihmuar neve duke marrë literaturë nga Shqipëria. Ka qenë biblioteka me libra shqip ku kemi shkuar dhe jemi furnizuar me libra aty.

Po ashtu ka qenë fondi i, për ndihma për Kosovën, “Hilfe für Kosova”, domethanë ka qenë ku janë derdhur të holla domethanë. S’ka pasë kush e di çfarë fondi, se ne gjithë ato paratë e fundit i kemi dhanë, si të thuash, për gazeta, për aktivitete edhe ata na kanë ndihmuar shumë domethanë. Në shtëpinë e tyre ka qenë adresa e redaksisë, ku njerëzit janë drejtuar nga të gjitha kontinentet domethanë. Ka qenë në adresë e njohur. Kështu që, kemi vepruar domethanë me protesta, me demonstrata, greva e minatorëve kur është mbajtur gjithashtu. Domethanë, vazhdimisht kemi qenë në aktivitet.

Anita Susuri: Kur ka ndodhë greva e minatorëve, çfarë aktivitete, po më intereson, se ka qenë kthesë historike ajo kur osht’ marrë edhe kushtetuta kur është marrë autonomia e Kosovës?

Saime Isufi: Po, po, po, po. Ne kemi shkuar në Gjenevë domethanë kemi majtë grevën, grevë kështu. Domethanë, duke qëndruar në javë ditë aty para Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të sensibilizuar opinionin ndërkombëtar. Se edhe shumë protesta, demonstrata i kemi organizuar para OKB-së dhe kemi përcjellë petitionet me kërkesat tona. Domethanë, nuk ka ndodhë të bëhet në ngjarje këtu... ose helmimi i nxënësve kur ka qenë domethanë në ‘90-ën, 1990. Ne, si të thuash, kemi ngritë zërin edhe atje që çfarë po ndodhë në Kosovë. Domethanë, kemi qenë në zë, jemi përpjekë të jemi në zë i Kosovës, sepse këtu ka qenë gjithçka e mbyllur, nuk kemi pasë mundësi të dalësh hapur me ato çfarë ka ndodhë.

Anita Susuri: Po më intereson, në cilin vit, po më duket fundi i viteve ‘80-ta, fillimi i ‘90-tave ka qenë veprimtaria e organizatës pastaj ka ndryshu pak qasja...

Saime Isufi: Po. Po, po, sepse atje kanë bo pastaj edhe ndryshime normal sipas, sipas situatave, si të thuash, po megjithatë puna ka vazhduar. Domethanë, kanë qenë ato mosmarrëveshjet, mospajtimet siç janë domethanë. Ato aksionet, jo lëvizje me adresë, lëvizje pa adresë si të thuash. Po qëllimi ka qenë i përbashkët prapë domethanë. Puna ka vazhduar megjithatë deri te formimi i celulave të para të UÇK-së.

Anita Susuri: Po më intereson edhe kjo vitet e ‘90-ta që kanë qenë, se në Kosovë ka ndryshu këto...

Saime Isufi: Po.

Anita Susuri: Pastaj edhe janë largu njerëzit prej institucioneve, prej punave...

Saime Isufi: Po, po, po.

Anita Susuri: Po më intereson si ka qenë aktiviteti tash në vite të '90-ta?

Saime Isufi: Domethanë, po, kanë ardhë edhe atje jashtë domethanë kanë fillu të dalin shumë atje. Atje për shembull osht' organizu edhe mësimi plotësues i shkollës shqipe, se ma herët ka qenë i organizuar edhe nëpërmjet ambasadës jugosllave mësimi plotësues. Ne filluam ta bëjmë të pavarur mësimin plotësues atje, si të thuash. Kam qenë kryetarja e parë e Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë në Zvicërr pas ndarjes nga ambasada jugosllave, të mësimi. Kam vazhduar me mësimin plotësues domethanë, aty kam dhënë kontributin tim për 25 vjet me radhë, duke qenë mësuese e mësimi plotësues. Po ashtu kom marrë pjesë edhe në, në projekte të ndryshme me shkollat zvicerrane. Kom punu në shkollat zvicerrane, kam mbajtur kurse edhe për zvicerranet, kurse në gjuhën shqipe në institucione të ndryshme. Domethanë kam qenë aktive edhe sa i përket arsimit, arsimimit domethanë. Edhe kjo ka qenë ni anë, si të thuash, e patriotizmit të shqiptarëve në mërgim sepse është dashur t'ju shkojmë prindërve nëpër shtëpi, t'i mobilizojmë që t'i çojnë fëmijtë në shkollën shqipe për të ruajtur gjuhën e kulturën.

Anita Susuri: Ju thatë që keni vazhdu me jetu në vendin ku fillimisht keni shku...

Saime Isufi: Po.

Anita Susuri: Ku keni jetu sigurisht edhe me Kadri Zekën...

Saime Isufi: Jo, jo, në fakt, sepse ne kemi jetuar me Kadri Zekën në St. Gallen, është në veri të Zvicrrës. Kurse miqtë zvicërranë i kemi pasur te qyteti ku jetoj unë tash, ku e kemi pasur adresën. Pas asaj ngjarjes që ndodhi aty, atëherë ky çifti zvicërran më preferoi të vija këtu, në këtë qytet sepse ata do të më ndihmonin duke organizuar avokat për qëndrimin tim. Sepse ne nuk ishim të kurorëzuar, si të thuash, me dokumente sepse ishte ni kohë vërtetë ni kohë e pa kohë. Kush e kishte mendjen te dokumentat e te domethanë për të bërë ni martesë zyrtare.

Kështu që, ishte domethanë pak problem qëndrimi aty, domethanë sepse Kadriu ishte vra dhe mund edhe ishte e rrezikshme të qëndronte në shtet për shtetin nifarë mënyre, se, "Ne nuk duam të na ndodhi", thoshin, "siç ka ndodhë në Gjermani të na ndodhi në Zvicërr diçka e tillë". Domethanë, se si shtet ma neutral, e ma demokratik e s'di çka domethanë. Këta miqtë zvicërranë më preferuan që të vijë më mirë në atë qytet, ku do t'isha më afër tyre dhe do të më ndihmonin. Për tre muaj unë as s'disha gjuhën. Domethanë, s'kisha ecur, isha edhe goditur, si të thuash, edhe shpirtërisht edhe ishte e vështirë

ta merrja vetën për momentin si të thuash. Kështu që, qëndrova aty dhe aty pastaj kam vazhduar nuk e kam ndrruar ma qytetin, ku vazhdoj edhe sot.

Anita Susuri: Pas sa kohe keni fillu prapë me aktivitete? Folëm edhe ma herët që domethanë janë arrestu edhe janë vra... tre persona i keni humbë në atë kohë. Po pas sa kohe keni fillu...

Saime Isufi: Menjëherë. Na s'jemi ndalë, menjëherë, po, po; që me vrasjen e tyre, unë kam mbajtur një fjalë atje domethanë kundër vrasjes së tyre. Kam folë domethanë se në këtë drejtim kam qenë nifare mënyre e përgatitur, si të thuash, dhe rruga nuk është ndalë e kam pasë si detyrim. Ajo s'ka pasë ndalje ma, nuk ka pasë shkëputje nga ajo. Përkundrazi, kam vepru edhe më shumë edhe më me entuziazëm. Duke pasë, duke ndjerë si detyrim ndaj atyre që ranë, por edhe ndaj atyre që ishin në burg. Ne shokët i kishim në burg këtu. Ishte, vetëvetiu, ishte ni detyrim ndaj çështjes se do të vazhdoj. Një bie, të tjerët do të vazhdojnë punën e tyre. Është një amanet i lënë në gjysmë.

Anita Susuri: Ju në atë kohë edhe jeni, domethanë, prej shtetit jugosllav jeni pa si udhëheqëse...

Saime Isufi: Po.

Anita Susuri: E grupit edhe prandaj ndoshta edhe ka qenë shumë rrezik prej juve m'u kthy...

Saime Isufi: Po, po, ashtu osht'. Unë në fakt jom kthy. Unë kom ardhë ilegalisht nja dy herë...

Anita Susuri: Po a? (qeshë)

Saime Isufi: Po (qeshë). Unë kom ardhë pak më vonë disi, sepse domethanë kokë në vete kam bërë atë pa më thanë askush po kokë në vete. Kam vendosur të vi në Kosovë, kam ardhë në Kosovë. Nuk e di si kam ardhë. Sot me më thanë s'do ta bëja atë veprim, po e kam bërë atëherë. Kam ardhur domethanë dhe pastaj kanë shkruar gazetatat, në fakt jugosllave që "*Ilustrovana politika*" ka aty ni gazetë. Domethanë, ku jam unë në mes dy aktivistëve. Pastaj, ata me ato si të thush me formulimet e tyre që jam nga shteti shqiptar si agjente e tyre, s'di çka domethanë. Kanë shkruar, kanë bërë. Po unë po të më kishin zënë normal si shoktë e mi, s'dua ta mbivlerësoj vetën, po ata të kanë dënuar për ni libër, për asgjë, për ni këngë shqipe. Le ma të kisha bërë, të kishe vepruar ni organizatë, sigurisht që do ta pësoja si shoktë e mi...

Anita Susuri: Keni qëndruar për pak kohë e jeni kthy apo si?

Saime Isufi: Po, për pak kohë, për të vizituar familjen. Thashë nuk i kom borxh askujt, do të shkoj te familja ime dhe kam ardhë te familja ime. Në fakt erdha te familja ime, po aty erdhën shokë e shoqe të vizitojnë. S'di si si ka ndodhë që unë kam shpëtuar pa u arrestuar. Pastaj, erdha edhe niherë tjetër po aty s'më lanë me u ekspozu familja. Kështu që, nejta fshehur te familja e Kadriut. Aty më mbajtën

gjatë, tërë kohës nejta aty, sepse ishte domethanë, ata kishin marrë vesh që kisha qenë njëherë dhe s'desha edhe familjes time, t'ju bëja, domethanë, ni ngarkesë. Me vllaun tim kishin përjetuar. Vllaun e kam pasë gjashtë vjet në burg dhe s'doja unë që t'ju bëhesha, si të thuash, t'i krijoja një vujtje prindërve të mi se mjaft e vuajtën ata largimin tim, mungesën time, s'doja domethanë t'i ngarkoja më tepër.

Anita Susuri: Thatë që varësisht nga ndryshimi i politikës ka ndryshuar edhe aktiviteti dhe organizatat janë përshtatë kështu. Thatë që në formimin e celulës, UÇK-së, celula qita s'deshta me thanë (qeshë)...

Saime Isufi: Po, po, po.

Anita Susuri: Me formimin e UÇK-së...

Saime Isufi: Po, po.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë krejt kjo përshtatja?

Saime Isufi: Domethanë, po. Ne, domethanë, gjithmonë kemi thanë, gjithmonë e kemi qujtë edhe veprimin tonë ni lloj lufte, domethanë, pavarësisht që me armë. Po e kemi ditë që ne nga armiku nuk do të shpëtojmë pa luftë, sepse s'kemi fituar asgjë pa luftë. Kështu që, ne nifarë forme jemi përgatitur për ni diçka të tillë. Po kur filloi lufta, sigurisht, domethanë pa filluar lufta në Kosovë janë mbajtur ato. S'mund të them që kam qenë pjesë e organizimit, sepse ne kemi qenë, si të thuash, në atë kohë doli Lidhja Demokratike e Kosovës dhe ni pjesë u bashkuan me Lidhjen Demokratike këtej dhe nifarë mënyre u çorientuam atje domethanë. Ni pjesë e shokve tanë ishin fut në Lidhjen Demokratike. Ne që ishim pak më revolucionarë ne s'donim, sepse ne kemi bo punën, ne do të vazhdojmë. Sepse duke u nënshtruar nuk fitojmë asgjë. Kështu që, u bo ni lloj përçarje edhe në Zvicërr siç ndodhë gjithkunj.

Pavarësisht, unë i kam përfshi shokë e shoqe. Na kanë nda disa, si të thush, pjesëmarrje. Po faktikisht unë vet jam angazhuar më tepër në arsimin shqip me nxanësit. Nuk, nuk e kam ndihmuar UÇK-në si të thuash me ndihma materiale. Kemi organizuar edhe një shoqatë të gruas "Drenica", të formuar në atë qytetin ku jetoj unë ka qenë domethanë e formuar organizata. Sepse kemi qenë të lidhur me ngjarjen këtu. Kemi ndjekur si të thuash, e kemi vuajtur atë, si të thuash, atë kohë edhe ne atje për familjet tona, për njerëzit tanë, për të gjithë, për vendin tonë. Në atë shoqatë, si të thuash, kemi vepruar si gra, kemi mbledhë ndihma materiale. Ju kanë dërgu njerëzve këtu, ju kanë dërgu njerëzve në Shqipni. Domethanë, të gjithë refugjatëve që... në qit formë kemi vepruar më tepër. Kurse unë kam qenë e angazhuar në, në arsim më tepër, në shkollën shqipe mësim plotësues. Edhe sot jam koordinatorë në kantonin ku jetoj.

Anita Susuri: E qysh ka qenë përjetimi kur ka fillu lufta prej '98-ës me vrasjen e Familjes Jashari pastaj te masakra në Çirez që ka ndodhë...

Saime Isufi: Po shiko, i kemi përcjellë me shqetësim të madh normalisht. Ne kemi qenë sy e vesh nën njoftimin në lajme. Vllavin e kom pasë komandant të zonës së Karadakut. Pastaj i kom pasë shokët që më kanë... Jakup Krasniqin, Berat Luzhën, më janë lajmëruar nga fronti i luftës, “Ne do të fitojmë, ne do të bëjmë”, domethënë. Ishte ni kurajo. Pastaj Mehmeti më është paraqitur në Rambuje kur kanë shkuar për bisedime në Rambuje. Domethanë, ka qenë ni lidhje kështu shumë shpirtërore. Janë përpjekë domethanë moralisht të jem me ta. Pavarësisht që unë në atë kohë kam qenë shtatzënë, sepse unë u martova më vonë dhe... pas 15 vitesh jam martuar dhe isha shtatzënë në atë kohë se atdheu na thrriste. Po kështu ka qenë koha.

Anita Susuri: Po mendoj me familjen a keni qenë në kontakt? A kanë qenë ata në Kosovë?

Saime Isufi: Shumë e vështirë ka qenë. Shumë ka qenë e vështirë të kontaktoje me familjen. Familja ime ka qenë në Gjilan normal. Këta nuk i kanë dëbuar Gjilanin, siç i kanë dëbuar vendet e tjera. Gjilanin s’e kanë dëbuar po rrethinën po. Motrën e kam të martuar në Përlepnice dhe ata për shembull i kanë, i kanë dëbuar me autobus. Familja ime nuk ka mundur as me të marrë kontakt, sepse Gjilani ka qenë i rrethuar. Thonë siç ka qenë në atë kohë, që në një vend të quajtur Gllam kanë qenë ato, si të thuash, gropat e hapura për të bërë masakër dhe për t’i futur njerëzit siç kanë bërë në shumë vende tjera.

E di që në Stankovec domethanë motra ime, kurse familja kanë qëndru në Gjilan pot të fshehur nëpër shtëpi. Babai im ka qëndruar në shtëpi, nuk e ka lëshu siç e kemi zakon ne shqiptarët. Nuk e lëshoi shtëpinë. Aty kanë hyrë domethanë në shtëpinë e babës tim, e kanë lidhë babain tim dhe e kanë kërcënuar, “Ku e ke ti Komandant Rexhën?” Sepse vllai ka mbajtur emrin e Rexhep Malës, domethanë si hero dhe është qujtë komandant Rexha. Ai nuk e ka, normal që nuk e ka tregu djalit e tij dhe ka thanë, “Nuk e di ku osht”. Pastaj kanë filluar mobilet apo gjërat e shtëpisë të gjitha t’i thyejnë, t’i bëjnë, domethanë, t’i dëmtojnë për të krijuar frikë e panikë. Për fat të mirë nuk ka qëlluar, përveç babës, askush në shtëpi.

Kanë hedhë bombë në oborr, po nuk është dëmtuar njeri domethanë, për fat të mirë. Por me vonesë domethanë. Nga familja nuk është dëmtuar njeri, domethanë nuk është vrarë siç ka ndodhë masakra në Drenicë e në vende tjera. Gjilani ka qenë ma i paprekur, si të thuash, në këtë, në këto masakra, në këto. Ndoshta është rujtur për ma vonë, po pastaj hynë trupat e NATO-s dhe shpëtoi. Përndryshe, me sy e vesh kemi qenë të gjithë, se s’ka rëndësi a ndodhë në Drenicë, a ku ndodhë. Kosova është Kosovë, është vendi ynë domethanë. Kemi vuajtur shumë. Vuan njeriu kur është në vendngjarje, po kur je jashtë atdheut je edhe më shumë i prekur e i... kemi qenë vërtetë sy e vesh në Kosovë vazhdimisht.

Anita Susuri: E çfarë përjetimi ka qenë kur është shpëtu Kosova? Se është ni punë e juja prej rinisë...

Saime Isufi: I paparë. Ajo ditë ka qenë për mua (qan) shumë s’di, tërë ditën kam qajtur. Sepse në qytetin tonë u organizu si në çdo qytet të Zvicrrës dolën jashtë. Unë s’kam mujtë të dalë. Më kanë thirrë në telefon, “Dil, dil, ti ke kontribu”. Nuk kam mundur. Vetëm kam qajtur nga gëzimi, domethanë

tërë ditën. Dy herë në jetën time kam qajttë nga gëzimi, domethanë, kur shliru Kosova dhe kur kam lindur djalin tim. Po ka qenë vërtetë e pabesueshme, sepse ne kemi kontribuar, kemi vepruar. Po kurrë s’kemi menduar që një ditë do të shlirohet Kosova, do të vijmë kështu të lirë të hyjmë e të dalim. Domethënë, pavarësisht që s’jemi të kënaqur me shumë gjëra, po është bo ni punë shumë e madhe. Duhet të jemi të kënaqur me këtë që ne lëvizim të lirë. Ne përshëndetemi me policët shqip, ne s’kemi frikë nga polici shqiptar, ne duhet të respektojmë këtë shtet, këtë vend. Pavarësisht që me shumë gjëra s’jemi të kënaqur, po gjërat ecin përpara. Është bërë shumë punë e madhe, është derdhë gjak, janë bërë shumë sakrificat. Këto duhet të respektohet e kaluara, këto s’duhet të harrohen nga askush.

Anita Susuri: Pastaj keni ardhë shpejt në Kosovë besoj?

Saime Isufi: Shtatzanë kam ardhë menjherë. Domethanë, si osht’ shliru kam ardhë. Pavarësisht që kam pasë një presion nga familja e bashkëshortit tim, nga familja ime, jo kështu. Ju kam thënë, “Unë jam shumë e fortë dhe s’do ndodhi asgjë, do shkoj”.

Anita Susuri: Pas sa kohe ju ka ra me udhët?

Saime Isufi: Domethanë, në qershor, po menjherë, menjherë.

Anita Susuri: Po mendoj që keni qenë larg? Dy herë thatë kom ardhë...

Saime Isufi: Aha, po, po. Domethanë, pas atyne dy herëve? Se ato mos m’i llogarit dy herë hiç se (qeshë). Po ‘81 domethanë ‘98-‘99. Po. Po unë përsëri jam përpjekë të mbaj kontakte me familjen time sepse unë kam shkuar në Shqipëri, në Durrës. Pastaj, familja ime ka ardhë në Shqipëri, nëna ime për shembull ka ardhur me pasaportë të motrës, dyjat me shamija, s’i ka njoftë njeri, si motra. I falënderoj tezet e mia, kanë bërë shumë për nënën time, sepse i kanë pasë burrat në Gjermani dhe po të hetoheshin domethanë që këto po ndihmojnë kanë qenë të rrezikuar familja me nga shtatë-tetë fëmijë. Nuk ka qenë e lehtë, por si të thuash, përsëri kam qenë mënyrën që t’i takoj. Të paktën nënën, babain, motrën gjithashtu kam takuar dy-tre herë i kam takuar. Në Durrës jemi takuar, i kemi bërë pushimet bashkë.

Anita Susuri: Tash e vazhdoni jetën e juaj në Zvicërr...

Saime Isufi: Po.

Anita Susuri: Me familje...

Saime Isufi: Po, po.

Anita Susuri: E keni djalin apo edhe...

Saime Isufi: Djalin, ni djalë e kam. Djalin e kam, po. E kam, është gjëja më e çmuar në botë. Domethënë, vërtetë të bëhesh nënë... kur ra Kadriu merakë më i madh më ka mbetur që s'u bëra nënë domethanë. Ky ka qenë pengë im. Siç është çdo e re domethanë kur je e dashuruar e kështu që më thuaj jo kurrë s'do ndodhi, kurrë s'do ndodhi më. Po mas 15 vitesh ndodhi, s'e kam bërë as për heroizëm, as për asgjë tjetër, por nuk doja njeri. Thjeshtë nuk ndjenja për asnjëri. Po kur ndodhi ajo, unë u martova në Shqipëri domethanë, në Tiranë. Kështu që e lindi edhe djalin tim...

Anita Susuri: Cilin vit po i bie që...

Saime Isufi: '97.

Anita Susuri: '97.

Saime Isufi: '97, po. Pak para luftës, po, po. Kështu që...

Anita Susuri: Zonja Saime, nëse keni edhe diçka me shtu për fund, nëse doni me përmend diçka...

Saime Isufi: Çka të them, unë ju falënderoj shumë për këtë ftesë, e mora me kënaqësi ftesën tuaj, sepse kjo gjëra duhet thënë. Bile, për ata që janë ende në jetë është mirë të dihet e kaluara, nga ata që janë në jetë sepse të ritë, e ardhmja do të, historia do t'i qes në pah domethanë të gjitha ato që janë bërë. Sepse janë bërë, vërtetë është, njerëzit kanë sakrifikuar shumë.

Anita Susuri: Faleminderit juve!

Saime Isufi: Faleminderit edhe juve dhe suksese në punën tuaj!

Anita Susuri: Faleminderit! Gjithashtu.